

PLATFORMË E BARAZISË GJINORE NË PRIZREN

**Për politika publike që sigurojnë
barazi politike, ekonomike,
sociale dhe kulturore mes gjinive**



Prizren - 2017

COPYRIGHT © 2017. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar të bëjë të qartë burimin e sigurimit të citateve apo materialeve të cilët shfrytëzohen.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Ky publikim është realizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës në bashkëpunim me OJQ-në Ec Ma Ndryshe dhe iniciativën e grave dhe vajzave të Komunës së Prizrenit, FEMaktiv, ndërsa publikimi është bërë i mundur me përkrahjen e Olof Palme International Center. Opinonet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë analizë janë përgjegjësi e KDI-së, Ec Ma Ndryshe dhe FEMaktiv dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PËRMBAJTJA

▼ **04**

HYRJE

▼ **14-15**

ARSIMI DHE AFTËSIMI PROFESIONAL

▼ **05**

Grupet e problemeve
të identifikuar

▼ **16-17**

KORNIZË ORIENTUESE PËR
POLITIKA MË TË MIRA

▼ **06- 07**

QASJA NË KUJDESIN SHËNDËTËSOR

▼ **08- 09**

TREGU I PUNËS DHE NDËRMARRËSIA

▼ **10-11**

SIGURIA PERSONALE DHE PUBLIKE

▼ **12-13**

PËRFAQËSIMI PARTIAK (DHE POLITIK)



HYRJE

Ky dokument është hartuar përmes një procesi konsultues dhe synon të shërbejë si kornizë orientuese për politikën publike të Komunës së Prizrenit në çështje të barazisë gjinore. Për hartimin e këtij dokumenti fillimisht janë mbajtur dy punëtori me përfaqësues nga parti politike, biznese, organizata të shoqërisë civile dhe grupe të tjera. Paralelisht, në disa takime të zhvilluara kryesisht me gra kandidatë për Kuvendin e Komunës, janë identifikuar çështje me interes të veçantë për ato dhe platformat politike të partive të tyre politike. Përfundimisht, drafti i këtij dokumenti është prezantuar para kandidatëve gra të të gjitha subjekteve politike të Prizrenit, duke u plotësuar me sugjerime shtesë nga to. Kjo platformë në të njëjtën kohë nxjerr përfundime edhe nga tri hulumtime që janë realizuar gjatë kësaj periudhe dhe që mbulojnë temat e tregut të punës, punësimit të grave dhe nënave vetushqyese. Dokumenti pasqyron

Përfundimisht, drafti i këtij dokumenti është prezantuar para kandidatëve gra të të gjitha subjekteve politike të Prizrenit, duke u plotësuar me sugjerime shtesë nga to. Kjo platformë në të njëjtën kohë nxjerr përfundime edhe nga tri hulumtime që janë realizuar gjatë kësaj periudhe dhe që mbulojnë temat e tregut të punës, punësimit të grave dhe nënave vetushqyese.

edhe dinamikën globale të përpjekjeve për t'i luftuar pabarazitë si dhe bazohet në një numër hulumtimesh të realizuara në Kosovë dhe vendet e tjera.





GRUPET E PROBLEMEVE TË IDENTIFIKUARA

Në diskutimet e zhvilluara (intervista, punëtori dhe takime individuale) me gratë aktiviste (parti politike, organizata të shoqërisë civile, biznese) janë identifikuar një numër i çështjeve të rëndësishme së veçantë për gratë dhe vajzat e Prizrenit. Gjatë këtyre diskutimeve, përveç identifikimit të sfidave, nga pjesëmarrëset është kërkuar të ofrojnë edhe zgjidhje eventuale, të cilat mund të përkthehen në politika publike të Komunës së Prizrenit dhe autoriteteve tjera publike lokale dhe qendrore. Për nevojat e këtij dokumenti, çështjet e identifikuar të natyrës sociale, ekonomike dhe politike janë grupuar në pesë grupe të problemeve: Qasja në kujdesin shëndetësor, Tregu i punës dhe ndërmarrësia, Siguria publike dhe personale, Përfaqësimi partiak (dhe politik) dhe Arsimi dhe aftësimi profesional.

Për nevojat e këtij dokumenti, çështjet e identifikuar të natyrës sociale, ekonomike dhe politike janë grupuar në pesë grupe të problemeve: Qasja në kujdesin shëndetësor, Tregu i punës dhe ndërmarrësia, Siguria publike dhe personale, Përfaqësimi partiak (dhe politik) dhe Arsimi dhe aftësimi profesional.





QASJA NË KUJDESIN SHËNDËTËSOR

Ndonëse janë ndërmarrë mjaft veprime në nivel global nga viti 1995 kur u nënshkrua Deklarata e Pekinit, gratë ende ballafaqohen me probleme të shumta, posaçërisht në çështje të shëndetit. Organizata Botërore e Shëndetësisë radhit këto dhjetë çështje si më prioritetet për shëndetin e grave: kanceri, shëndeti riprodhues, shëndeti gjatë shtatzënisë dhe lindjes, HIV, infeksione seksualisht të transmetueshme, dhuna kundër grave, shëndeti mendor, sëmundje jongjitime, të qenit e re dhe plakja. Sipas hulumtimit të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës mbi qasjen në kujdesin shëndetësor, në vendin tonë vendimet e rëndësishme në amvisëri duke përfshirë edhe atë se kur gratë dhe fëmijët duhet të shkojnë te mjeku mbeten kryesisht te burrat, dhe kjo mund të pengojë qasjen e grave në kujdes shëndetësor.

Hulumtimi gjithashtu ka gjetur se në rastet kur burimet financiare të familjes janë të pakta, anëtarët meshkuj të familjes mund të kenë prioritet për kujdes shëndetësor. Njohuria e pamjaftueshme për atë se ku dhe si të merret kujdesi shëndetësor duket se pengon shumë qytetarë nga kërkimi dhe qasja në kujdes shëndetësor, duke përfshirë informatat për planifikim familjar. Në hulumtimin e RrGGK thuhet se kjo ka qenë veçanërisht e dukshme te metodat e planifikimit familjar, dhe mënyra se si punëtorët shëndetësorë ende demonizojnë kontraceptivët hormonal për shkak të efekteve të tyre të mundshme anësore.



Gjatë diskutimeve të zhvilluara me gratë aktiviste të Prizrenit këto çështje specifike të kujdesit shëndetësor janë identifikuar si më sfiduese dhe urgjente për trajtim:

- 1 Mungesë informacioni publik dhe përgatitje e duhur e personelit shëndetësor mbi shëndetin riprodhues të gruas,
- 2 Vështirësitë në qasje fizike në qendrat e kujdesit shëndetësor (niveli primar), sidomos për gratë në gjendje të vështirë ekonomike dhe gratë që jetojnë në zonë rurale,
- 3 Gratë që i përkasin komuniteteve jo-shumicë kanë qasje më të mangët në shërbime shëndetësore krahasuar me gratë e komunitetit shumicë shqiptar,
- 4 Pengesat socio-kulturore që mund të ndikojnë në rregullshmërinë e vizitave të grave në qendrat e kujdesit shëndetësor,
- 5 Niveli i përgjithshëm i ultë i besimit publik në institucionet publike të shëndetësisë dhe orientimi në klinika private.



Njohuria e pamjaftueshme për atë se ku dhe si të merret kujdesi shëndetësor duket se pengon shumë qytetarë nga kërkimi dhe qasja në kujdes shëndetësor, duke përfshirë informatat për planifikim familjar.



TREGU I PUNËS DHE NDËRMARRËSIA

Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) gratë vazhdojnë që të përballen me pengesa të rëndësishme në qasjen në vende pune të mira. Kjo organizatë konsideron se ka pasur vetëm përmirësime marginale në këtë drejtim që prej mbajtjes së Konferencës së Katërt Botërore për Gratë në Pekin në vitin 1995. Të dhënat e prezantuara nga kjo organizatë tregojnë se ndërmjet viteve 1995 dhe 2015 përqindja e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore globale ka rënë nga 52.4 për qind në 49.6 për qind. Në Raportin e Zhvillimit Njerëzor 2016, UNDP ka theksuar se Kosova ka shkallën më të ulët të punësimit të grave në rajon me 12.5 për qind. Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore 2016 të Agjencisë së Statistikave të Kosovës shkalla e punësimit ishte më e lartë për burra se sa për gra, ku 43.0 për qind të burrave në moshë pune ishin të punësuar krahasuar me 12.7 për qind të grave po ashtu në moshë pune.

Sipas Indeksit të Ndërmarrësisë Globale Gjinore dhe të Zhvillimit, gratë sipërmarrëse sikurse edhe burrat, ndikohen nga mjedisi i përgjithshëm i biznesit ku veprojnë, por në disa raste, institucionet zyrtare sikurse edhe rrethanat kulturore krijojnë pengesa shtesë për gratë, duke e penguar fillimin ose rritjen e ndërmarrjes. Si pasojë, gratë kanë qasje më të kufizuar në burimet për zhvillim, siç janë arsimi, zhvillim të aftësive dhe financat. Në Kosovë çdo i nënti biznes është në pronësi të grave, ndërsa sektorët në të cilët janë angazhuar gratë si pronare janë kryesisht sektorë me vlerë të ulët, dhe jo të tregtueshëm. Në 3 mujorin e parë të vitit 2017 në Qendrën e Regjistrimit të Bizneseve në Prizren janë regjistruar 31 biznese me pronare gra, nga gjithsej 224 ndërmarrje të regjistruara, apo 13.83 për qind. Ndërkaq në nivel vendi nga 2850 biznese të regjistruara në 3 mujorin e parë të 2017, vetëm 339 biznese janë me pronare gra (11.9 për qind).



Gjatë diskutimeve të zhvilluara me gratë aktiviste të Prizrenit këto çështje specifike të tregut të punës dhe ndërmarrësisë janë identifikuar si më sfiduese dhe urgjente për trajtim:

- 1 Gjuha diskriminuuese e konkurseve të punës dhe mosrespektimi i të drejtave të punës të grave, sidomos atyre të punësuarë në sektorin privat,
- 2 Diskriminim i grave që planifikojnë ose janë në periudhë të shtatzanisë për t'i evituar obligimet ndaj pushimit prindëror,
- 3 Hapësirë e pamjaftueshme në institucionet parashkollore dhe sidomos mungesa e mundësive për çerdhe me kosto të përbalueshme,
- 4 Kurrikula shkollore, me theks në institucione shkollore të aftësimi profesional, që nuk ofrojnë shkathësi në drejtime që kërkohen nga tregu i punës,
- 5 Mungesa e politikave specifike të komunës për mbështetjen e grave sipërmarrëse, për të kapitalizuar potencialin e tyre në ekonomi,
- 6 Përkundër kërkesave të përsëritura, komuna ende nuk e ka rishikuar politikën e taksave komunale në raport me bizneset në pronësi të grave,
- 7 Numër shkajshmërisht i vogël i grave fermere që përfitojnë nga skemat e subvencionimit në bujqësi.



SIGURIA PERSONALE DHE PUBLIKE

Perveç problemeve të qasjes në tregun e punës, gratë në Kosovë përballen edhe me dhunën në familje. Sipas Kombeve të Bashkuara, në mbarë botën, 1 në 3 gra përjeton dhunë fizike ose seksuale ndonjëherë në jetën e saj nga partneri i saj. Në vitin 2014 në Policinë e Kosovës janë raportuar mbi 1179 raste të dhunës në familje, ku 79 për qind e viktimave ishin gra, ndërkaq 95 për qind e autorëve të krimit ishin burra. Kohëve të fundit, janë bërë publike edhe raste të tilla kur gruaja vritet nga partneri i saj intim. Edhe më shqetësues mbetet niveli i tolerancës ndaj dhunës fizike dhe dhunës në familje në Kosovë. Nje hulumtim i publikuar nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës dhe UNICEF (2015) tregon se mbi 42.2 për qind e grave në Kosovë besojnë që burri duhet justifikuar në rrethana të caktuara për dhunën ndaj grave.

Sa i përket sigurisë publike, gratë në Kosove, gati si në çdo vend tjetër të botës përballen me kërcënime të ngjashme duke filluar nga ngacmimet seksuale, dhuna seksuale, trafikimi. Një hulumtim i Rrjetit të Grupeve të Grave mbi ngacmimet seksuale në Kosovë, tregon që gratë në Kosovë pa dallim rajoni gjeografik, orientimi seksual, përkatësie etnike, niveli të arsimit, përballen me ngacmime seksuale. Rreth 64.1

për qind e grave në Kosovë raportojnë të kenë përjetuar ngacmim seksual, derisa 32.5 për qind e burrave raportojnë të njëjtën. Gratë zakonisht sulmohen nga persona të panjohur në rrugë. Sipas një hulumtimi nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë mbi trendet e perceptimeve të qytetarëve për sigurinë publike në Kosovë gratë ndihen më pak të sigurta në krahasim me burrat, meqë gratë në shkallë më të madhe kanë qenë viktime të ngacmimeve, llojeve të ndryshme të krimit siç është vjedhja si dhe formave të tjera të cenimit të integritetit trupor.

Me përjashtim të sheshit qendror të qytetit, zonat tjera urbane të Prizrenit vazhdojnë të paraqesin sfidë reale të sigurisë për gratë dhe vajzat, sidomos gjatë orëve te natës. Në veçanti, hapësirat publike të Prizrenit nuk janë mikpritëse për qytetarët dhe nuk janë të dizajnuara për të ofruar siguri për gratë dhe vajzat.



Gjatë diskutimeve të zhvilluara me gratë aktiviste të Prizrenit këto çështje specifike të sigurisë personale dhe publike janë identifikuar si më sfiduese dhe urgjente për trajtim:

- 1 Nivele të larta të raportuara (por edhe të paraportuara) të dhunës në familje dhe dështimi i institucioneve të rendit dhe ligjit për të ofruar siguri,
- 2 Mungesë e politikave specifike të komunës për të adresuar rastet e dhunës në familje në bashkëpunim me institucionet e sigurisë,
- 3 Hapësira publike të pasigurta për gratë dhe vajzat, me theks në mungesën e ndriçimit publik, numrin e madh të qenëve endacakë, ngacmimet seksuale në rrugë,
- 4 Mungesë e platformave publike (nga autoritetet, media dhe shoqëria civile) për të diskutuar hapur mbi sfidat e sigurisë personale dhe publike të grave dhe vajzave.



Me përjashtim të sheshit qendror të qytetit, zonat tjera urbane të Prizrenit vazhdojnë të paraqesin sfidë reale të sigurisë për gratë dhe vajzat, sidomos gjatë orëve të natës. Në veçanti, hapësirat publike të Prizrenit nuk janë mikpritëse për qytetarët dhe nuk janë të dizajnuara për të ofruar siguri për gratë dhe vajzat.



PËRFAQËSIMI PARTIAK (DHE POLITIK)

Përkundër faktit që përbëjnë gjysmën e popullsisë botërore, gratë vazhdojnë të mos kenë qasje në mundësitë dhe burimet e udhëheqjes politike në të gjitha nivelet e qeverisjes. Pjesëmarrja e barabartë e grave në vendimmarrjen politike nuk është vetëm një kërkesë për drejtësi e demokraci, por një parakusht i domosdoshëm që nevojat dhe intereset e grave të merren parasysh. Edhe pse politika e kuotës gjinore është në zbatim në Kosovë, ajo nuk paraqet strategjinë e vetme që mund të përdoret nga partitë politike për promovimin e pjesëmarrjes së grave në procese politike.

Partitë politike në vende të ndryshme të botës kanë themeluar forume dhe komitete të gruas brenda strukturave të tyre, kanë ofruar incentive financiare dhe programe të asistencës, kanë alokuar fonde për trajnime dhe ndërtim të shkathësive, dhe kanë themeluar platforma diskutimi dhe lobimi që gratë të arrijnë sukses në politikë. Disa parti politike kanë përdorur një qasje të kombinuar, derisa një pjesë tjetër kanë përdorur vetëm një nga këto mjete. Në veçanti, qeveritë kanë krijuar programe stimuluese për partitë politike që të promovojnë kandidatet gra në listat e tyre zgjedhore dhe struktura të brendshme partiake duke alokuar fonde shtesë publike dhe hapësirë mediale pa pagesë. Në disa raste, qeveritë kanë përdorur edhe masa ndëshkuese kundër partive politike që nuk u binden detyrimeve të përfaqësimit të grave brenda strukturave të tyre.



Gjatë diskutimeve të zhvilluara me gratë aktiviste të Prizrenit këto çështje specifike të përfaqësimit partiak (dhe politik) janë identifikuar si më sfiduese dhe urgjente për trajtim:

- 1** Gratë anëtare të partive politike përballen me konkurrencë të fortë, shpesh joparimore brenda nën-degëve të partive politike për t'u nominuar në lista të kandidatëve për zgjedhje,
- 2** Gjatë kohës së fushatave zgjedhore, gratë përveç që kanë përkrahje minimale nga partitë politike, jo rrallë përballen me fushata joformale që dekurajojnë votuesit t'i votojnë gratë,
- 3** Gratë vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuara brenda strukturave udhëheqëse të degëve të partive politike dhe në të shumtën e rasteve shtyhen të veprojnë brenda forumeve të grave,
- 4** Numri skajshmërisht i vogël, shpesh jo më shumë se një ose dy, i grave në pozitat e larta të ekzekutivit lokal,
- 5** Gratë shpesh përjashtohen edhe nga forumet publike të diskutimit të çështjeve politike, ku partitë politike preferojnë të përfaqësohen nga anëtarët burra.



Në veçanti, qeveritë kanë krijuar programe stimuluese për partitë politike që të promovojnë kandidatet gra në listat e tyre zgjedhore dhe struktura të brendshme partiake duke alokuar fonde shtesë publike dhe hapësirë mediale pa pagesë.



ARSIMI DHE AFTËSIMI PROFESIONAL

Në të gjitha diskutimet e zhvilluara për hartimin e këtij dokumenti, arsimit dhe aftësimi profesional i grave dhe vajzave është përmendur si çështje horizontale që prek të gjitha segmentet e angazhimit për barazi gjinore. Edhe pse statistikat e përgjithshme gjinore të shkollimit në të gjitha nivelet janë inkurajuese, një mori sfidash që u takojnë të dy niveleve të qeverisjes mbeten për t'u adresuar. Edhe pse numri i vajzave që diplomojnë në universitete është më i lartë se i djemve, qasja në tregun e punës mbetet sfidë për vajzat dhe gratë.

Gjatë diskutimeve të zhvilluara me gratë aktiviste të Prizrenit këto çështje specifike të arsimit dhe aftësimi profesional janë identifikuar si më sfiduese dhe urgjente për trajtim:

- 1 Mungesë e skemave për të stimuluar qasjen e vajzave nga zonat rurale me gjendje të vështirë ekonomike në shkollim,
- 2 Mirëmbajtja e stereotipeve gjinore në profesione, sidomos në institucionet shkollore dhe qeveritare të aftësimi profesional,
- 3 Kapacitete të kufizuara të institucioneve të aftësimi profesional për të ofruar aftësim në drejtimet që lidhen me kërkesat e tregut të punës,
- 4 Inkurajimi i vajzave për të studiuar në drejtime që çojnë kah profesioni i mësimdhënës, duke e mirëmbajtur idenë e profesionit "ideal" për gratë,
- 5 Shqetësime të përsëritura për nivelin e sigurisë për nxënësit në shkolla, sidomos për vajzat.





Edhe pse statistikat e përgjithshme gjinore të shkollimit në të gjitha nivelet janë inkurajuese, një mori sfidash që u takojnë të dy niveleve të qeverisjes mbeten për t'u adresuar. Edhe pse numri i vajzave që diplomojnë në universitete është më i lartë se i djemve, qasja në tregun e punës mbetet sfidë për vajzat dhe gratë.



KORNIZË ORIENTUESE PËR POLITIKA MË TË MIRA

Gratë dhe vajzat e Komunës së Prizrenit përballen me një numër të konsiderueshëm sfidash, ndërsa vëshirësitë në adresimin e tyre lidhen kryesisht me faktin se ato janë problem strukturore dhe për më keq, mendësia e përgjithshme i konsideron normale dhe të natyrshme. Të gjendura mes normave patriarkale të shoqërisë dhe politikave të pazbatuara të barazisë gjinore të autoriteteve të shtetit, problemet e grave dhe vajzave të Prizrenit shtrihen nga shtëpia ku jetojnë të shkolla, nga rruga ku ecin e vendi i punës, nga prezenca mediale të përfaqësimit politik dhe publik. Kjo pjesë e dokumentit të Platformës ofron një numër orientimesh për politika më të mira publike, bazuar në çështjet e identifikuara më sipër, dhe ka për synim të nxisë diskutimin e përgjithshëm publik sidomos gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e 22 tetorit.

Veprimi më urgjent në sferën e kujdesit shëndetësor është shtimi i informacionit publik dhe konsolidimi i përgatitjes së personelit shëndetësor në raport me shëndetin riprodhues të gruas. Paralelisht duhet punuar në lehtësimin e qasjes fizike të grave në qendrat e kujdesit shëndetësor, duke u fokusuar në gratë me vëshitrësi ekonomike dhe ato që jetojnë në zonat

rurale. Kujdes i veçantë duhet t’u kushtohet grave që u përkasin komuniteteve jo-shumicë, pasi që ato raportojnë nivele të shumëfishta të diskriminimit.

Për të luftuar diskriminimin e grave në proces të aplikimit për punë dhe në vend të punës kërkohet bashkëpunim më i ngushtë i autoriteteve të të dyja niveleve të qeverisjes, për t’u siguruar që inspektorati përkatës rrit angazhimin në identifikimin dhe parandalimin e këtyre rasteve. Për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të grave në tregun e punës, hapja e çerdheve të reja dhe në veçanti ofrimi i këtij shërbimi me kosto të përballueshme janë veprime të domosdoshme. Në anën tjetër, institucionet e aftësisimit profesional duhet të shtojnë fushat e aftësisimit në raport me kërkesat e tregut. Stimulimi i grave sipërmarrëse përmes programeve të veçanta të përkrahjes dhe ofrimi i lehtësirave tatimore për bizneset e udhëhequra nga gratë janë reformat të rëndësishme.

Rritja e bashkëpunimit mes të gjitha institucioneve është veprim i domosdoshëm për parandalimin e rasteve të dhunës në familje, e sidomos shtytës për sjelljes para drejtësisë të ushtruesve të dhunës. Hapësirat publike të





komunës duhet të vlerësohen nga perspektiva e sigurisë së grave dhe vajzave dhe duhen realizuar ndërhyrje të duhura për të mënjeluar rreziqet potenciale. Me rëndësi të veçantë për sigurinë publike janë: ndriçimi publik dhe qentë endacak. Bashkëpunimi i autoriteteve me organizatat e shoqërisë civile është edhe një veprim që mund të ndikojë në përmirësimin e gjendjes së sigurisë duke i sjellur këto sfida në diskutim të hapur publik.

Brenda strukturave të tyre, partitë politike duhet të ndërmarrin reforma përmbajtësore për përmirësimin e përfaqësimit të grave në vendimmarrjen partiake. Programe të veçanta të nxitjes së kandidateve gra për poste publike, përfshi skema të stimulimit financiar (nga partitë por edhe nga autoritetet publike) janë forma që kanë treguar rezultate të prekshme në vendet tjera. Numri i vogël i grave në ekzekutivin lokal është vazhdimësi e qasjes dekurajuese ndaj përfaqësimit të grave në vendimmarrje. Emërimi i grave në pozita të larta të ekzekutivit në raport me barabartë me burrat duhet të jetë obligim për kryetar/in e komunës.

Një nga veprimet e para të autoriteteve në sferën e arsimit duhet të jetë zbatimi i skemave për të lehtësuar qasjen në shkollim të vajzave nga zonat rurale me gjendje të vështirë ekonomike. Në veçanti, autoritetet publike në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile duhet të punojnë në luftimin e stereotipeve gjinore në profesione, si dhe në rritjen e sigurisë për vajzat në mjedise shkollore.

Për më tepër, autoritetet lokale duhet të sigurohen për veprime të shpejta dhe të vendosura për:

- 1** Luftimin e gjuhës diskriminuese ndaj grave në të gjitha hapësirat (nga rruga deri te shkolla, nga vend ii punës deri te mediat),
- 2** Vendosjen e standardeve të buxhetimit gjinor në komunë, për t'u siguruar që buxheti hartohet dhe shpenzohet në atë mënyrë që i adreson në mënyrë të drejtë nevojat e të gjitha gjinive,
- 3** Përveç çerdheve (dhe sidomos atyre me kosto të përballueshme), sigurimin e përkujdesjes për foshnjat nën moshën e pranimit në çerdhe,
- 4** Përkrahjen më të madhe të strehimores për gratë viktime të dhunës në familje, dhe sidomos gjetjen e zgjidhjes për periudhën pas daljes së grave nga strehimorja,
- 5** Rishikimin e planit të veprimit për barazi gjinore dhe vlerësimin e sfidave në përmbushjen e objektivave të këtij plani, duke siguruar burime shtesë njerëzore dhe financiare për zbatimin e agjendës për barazi gjinore të komunës.





Për të luftuar diskriminimin e grave në proces të aplikimit për punë dhe në vend të punës kërkohet bashkëpunim më i ngushtë i autoriteteve të të dyja niveleve të qeverisjes, për t'u siguruar që inspektorati përkatës rrit angazhimin në identifikimin dhe parandalimin e këtyre rasteve.

This publication is part of the project "United women for a gender friendly political, economic and social governance", implemented by (KDI, Ec ma Ndryshe and FEMaktiv, financed by Olof Palme International Center supported by Swedish Government. Content of this publication reflects author's opinions and not necessarily Olof Palme International Center opinions.

